



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1068/1 Prot.

Tiranë, më 12 . 10 . 2023

V E N D I M

Nr. 200, Datë 12 . 10 . 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 203 Regj, datë 04.10.2023, të paraqitur nga “Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë¹”, kundër Bashkisë së Tiranës, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Me anë të Vendimit nr. 662, datë 08.05.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë” (në vijim cituar Shoqata), është regjistruar si person juridik/organizatë joqeveritare, me seli në Tiranë, me kohëzgjatje të papërcaktuar, me kryetar A. P³.

Sipas shpjegimeve të dhëna, A. P, në cilësinë e përfaqësuesit të Shoqatës, në mes të tjerash informon se, Shoqata ka mbi një vit që bën kërkesa pranë Bashkisë së Tiranës, për paisjen nga ana e saj me zyrë për kryerjen e aktivitetit të Shoqatës, duke cituar se:

¹ Përfaqësuar nga kryetari i saj, z. A. P

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

³ Referuar Vërtetimit datë 06.12.2019, të Zyrës së Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

“Shoqata kërkon zgjidhje të situatës dhe mbi të gjitha pse kjo zvarritje, kur ne duam një ambient ku të vazhdojmë punën tonë? Kemi ngelur në mes të katër rrugëve, ndaj këkojmë zgjidhje sipas legjislacionit në fuqi për statusin e Invalidëve Para-Tetraplegjikë, miratuar nga parlamenti.”

Në përfundim të ankesës, Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë Dega Tiranë, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zgjidhjen e problematikës, duke ndërhyrë për marrjen e masave nga ana e Bashkisë Tiranë për pajisjen e Shoqatës me zyrë të përshtatshme, brenda qytetit të Tiranës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, konstatohet se:

Lidhur me pretendimin e Shoqatës për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizur, nga ana e Bashkisë së Tiranës, sa i takon mosmarrjes së masave për vënien në dispozicion të një zyre/ambienti për kryerjen e aktivitetit të Shoqatës, Komisioneri vlerëson si më poshtë:

Nga verifikimet e kryera rezulton se pretendimet e parashtruara nga subjekti ankues, Shoqata, janë shqyrtuar nga KMD, në kuadër të një ankese të mëparshme, për të cilën Komisioneri është shprehur me vendimin respektiv, si dhe nuk është depozituar asnjë provë, fakt apo e dhënë e re, për të iniciuar një procedurë hetimore për sa pretendohet.

Kështu, në kronologji kohore evidentohet se:

1. Pranë Komisionerit, është regjistruar ankesa me nr. 56 Regj, datë 29.03.2022, e paraqitur nga “Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë”, kundër Bashkisë së Tiranës, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”.
2. Në përmbajtje të saj, ankesa e mësipërme konsistonte si vijon:

“Sipas shpjegimeve të dhëna, A. P, në cilësinë e përfaqësuesit të Shoqatës, në mes të tjerash informon se, me vendimin e datës 19.07.2002 të Bashkisë Tiranë, Shoqatës i është dhënë një zyrë në përdorim. Mirëpo, kjo zyrë është prishur pa qenë të informuar dhe njoftuar paraprakisht ata si Shoqatë. Lidhur me këtë fakt, përfaqësuesi i Shoqatës, z. P, ka informuar se i është drejtuar institucioneve përgjegjëse për ta denoncuar atë.

Në ankesën e sjellë pranë KMD-së, Shoqata ka pretenduar se po diskriminohet nga Bashkia Tiranë, pasi nuk u është vënë në dispozicion një zyrë e përshtatshme dhe afër qendrës së Tiranës, pasi atyre u është ofruar mundësia për t’u dhënë në përdorim një zyrë tek ish-Reparti Ushtarak në Surrel. Këtë fakt Shoqata e ka kundërshtuar, me arsyetimin se rruga për tek objekti i ofruar është e pashtruar, nuk ka drita, ujë, si dhe nuk është mjedis i përshtatshëm për punë. Arsyetimet tjetër se përse Shoqata kërkon që zyra t’i jepet afër qendrës së qytetit, është për arsye shëndetësore, pasi individët që mund të kenë nevojë të adresojnë problematikat e tyre pranë kësaj zyre, janë invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë që lëvizin me karroca me rrota, gjë e cila pamundëson lëvizjen e tyre në një distancë aq të largët dhe në rrugë të pashtruar e të vështirë për të lëvizur për ta. Në këto kushte, pamundësohet veprimtaria e Shoqatës dhe përmbushja e objektivave të saj, duke cënuar njëherësh edhe qëllimin për të cilin ajo është krijuar dhe ekziston.

Moszgjidhjen e kësaj problematike nga ana e Bashkisë, Shoqata, e sheh si një diskriminim që i bëhet asaj, pikërisht për shkak të aftësisë së kufizuar, duke i mohuar një të drejtë që buron nga parashikimet ligjore.

Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, njuh rolin aktiv të shoqatave në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të individëve me paraplegji dhe tetraplegji. Në këtë kontekst, shteti financon veprimtarinë e Shoqatës sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim, duke vënë në dispozicion të saj dhe të japë falas mjedise për zhvillimin e veprimtarisë së saj⁴.

Në përfundim të ankesës, Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë Dega Tiranë, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zgjidhjen e problematikës, duke ndërhyrë për marrjen e masave nga ana e Bashkisë Tiranë për pajisjen e Shoqatës me zyrë të përshatshme, brenda qytetit të Tiranës.”

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri, nëpërmjet Vendimit nr. 180, datë 19.09.2022, Komisioneri ka disponuar:

“Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, “Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë e Tetraplegjikë, Dega Tiranë”, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në referim të pikës 1, Bashkia Tiranë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.”

4. Duke mos u dakordësuar me vendimmarrjen e Komisionerit, Bashkia e Tiranës e ka kundërshtuar gjyqësisht atë, duke kërkuar shfuqizimin e tij pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, nëpërmjet Vendimit me nr. 1098, datë 09.05.2023, ka disponuar rrëzimin e kërkesë padisë së paraqitur nga Bashkia e Tiranës, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ky vendim nuk është i formës së prerë pasi është apeluar nga pala ankimuese, Bashkia e Tiranës.

Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri vëren se, për sa i takon pretendimeve për diskriminim të subjektit ankues kundrejt Bashkisë së Tiranës, lidhur me mospajisjen e Shoqatës me zyrë për kryerjen e aktivitetit të saj, ato janë shqyrtuar nga Komisioneri në kuadër të ankesës me nr. 56 Regj., datë 29.03.2022, si dhe për të është konkluduar me një vendimmarrje konkrete, e cila është ende në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Për rrjedhojë, Komisioneri, mbështetur në nenin 33, pika 4/c e LMD, të ndryshuar, i cili përcakton se: *“Ankesa nuk pranohet nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankesë tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”*, gjykon se pretendimi i subjektit ankuesit për diskriminim nga e Bashkisë së Tiranës, në kuadër të ankesës me nr. 203 Regj., datë 04.10.2023, nuk mund të pranohet për shqyrtim,

⁴ Neni 14, i ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”.

pasi për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 20/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/c dhe 10 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e këtij vendimi

KOMISIONERI

Robert GAJDA